

Programi Zviceran për Bashkëpunim me Maqedoninë e Veriut 2021 - 2024



Tri fusha tematike prioritare



QEVERISJA
DEMOKRATIKE

Shoqëri e fortë qytetare

Menaxhimi transparent,
efikas dhe gjithëpërfshirës

Zgjedhje të lira dhe të
drejta demokratike



ZHVILLIMI I
QËNDRUESHËM
EKONOMIK

Zhvillimi i ekosistemit
afarist

Zhvillimi i aftësive dhe
qasja në punë të denjë

Situatë e qëndrueshme
makroekonomike



MJEDISI JETËSOR
DHE SHËRBIMET E
QËNDRUESHME TË
NDËRMARRJEVE
PUBLIKE

Përdorimi dhe mbrojtja e
qëndrueshme e burimeve
natyrore

Shërbime cilësore të
ndërmarrjeve publike

Komunitetet rezistente
ndaj përmbytjeve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

State Secretariat for
Economic Affairs SECO

Skanoi kodin
për të lexuar
dokumentin e
plotë



Bashkëpunimi zviceran me Maqedoninë e Veriut

Zvicra ka mbështetur tranzicionin politik, shoqëror dhe ekonomik të Maqedonisë së Veriut që nga viti 1992. Programi i ri i Bashkëpunimit 2021-2024 është një konfirmim i angazhimit të ardhshëm të Zvicrës për të vazhduar mbështetjen e saj. Programi monitoron proceset e reformave në Maqedoninë e Veriut që synojnë integrimin Euro-Atlantik dhe arrijtjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Fushat tematike me përparësi në bashkëpunim janë këto:

- **Qeverisja demokratike**
- **Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik**
- **Mjedisi jetësor dhe shërbimet e qëndrueshme të ndërmarrjeve publike**

Programi Zviceran i Bashkëpunimit do të përqendrohet gjithashtu në barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe dixhitalizimin. Programi i ri u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me partnerët në Maqedoninë e Veriut.

Programi zbatohet përmes projekteve të përbashkëta të bashkëfinancuara me Qeverinë, programeve me shumë donatorë dhe marrëveshjeve të drejtpërdrejta me organizata konsulente dhe qytetare maqedonase, zvicerane dhe ndërkombëtare, si dhe në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me sektorin privat. Vëmendje e veçantë në projektet e ardhshme do t'i kushtohet bashkëpunimit me sektorin privat.

Të gjitha aktivitetet kontribuojnë drejt qëllimit të vetëm: përmirësimi i standardit të jetesës së qytetarëve të Maqedonisë së Veriut.

Fushat tematike me përparësi

Qeverisja demokratike

Në fushën e qeverisjes demokratike, Programi Zviceran i Bashkëpunimit përqendrohet në rritjen e kapacitetit demokratik të institucioneve ekzekutive dhe legjislativë, si dhe forcimin e shoqërisë civile në Maqedoninë e Veriut. Si pasojë, Zvicra mbështet rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe gjithëpërfshirjes së institucioneve të pushtetit qendror dhe lokal. Zvicra përpiqet të mundësojë pjesëmarrje më aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe rajonal.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik

Maqedonia e Veriut ka potencial të madh për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe përpiqet të ndërtojë një ekosistem afarist të favorshëm. Në të njëjtën kohë, forcimi i përfshirjes së sektorit privat në arsimin dhe aftësimin profesional mbetet një nga prioritetet kryesore. Mbështetja zvicerane do të përqendrohet në fushat që do të kontribuojnë drejtpërdrejt në krijimin e vendeve më dinjitoze dhe formale të punës.

Mjedisi jetësor dhe shërbimet e qëndrueshme të ndërmarrjeve publike

Mbështetja e menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore në Maqedoninë e Veriut ka rëndësi të madhe. Programi Zviceran i Bashkëpunimit siguron mbështetje për përmirësimin e kapaciteteve të autoriteteve përkatëse nacionale dhe lokale dhe aktorëve të menaxhimit të burimeve natyrore në një mënyrë të qëndrueshme dhe përmes shembujve pozitivë për të ruajtur kapitalin natyror për brezat e ardhshëm.

Parimet kryesore

Programi Zviceran i Bashkëpunimit 2021-2024 promovon **përfshirjen sociale** të grupeve të cenueshme, si dhe përfshirjen e bashkësive të ndryshme etnike. Bashkëpunimi bazohet në të drejtat e njeriut, përfshirjen dhe parimet universale të "mos lini askënd pas."


Programi gjithashtu mbështet procesin e **dixhitalizimit** në vend duke promovuar inovacione dixhitale me potencial për të mbështetur: 1) forcimin e ndjeshëm të transparencës së institucioneve dhe qasjen në shërbime; 2) zhvillimin e politikave të mençura dhe shërbimeve të qëndrueshme; dhe 3) rritjen e produktivitetit dhe zhvillimin ekonomik.

Programi përqendrohet gjithashtu në parandalimin e rreziqeve që vijnë nga **ndryshimi i klimës**, degradimi i mjedisit dhe katastrofat natyrore. Të gjitha projektet përmbajnë masa që synojnë reduktimin e këtyre rreziqeve në mënyrë që të forcojnë qëndrueshmërinë e komuniteteve ndaj këtyre rreziqeve.

Zvicra do të vazhdojë të ndajë përvojat e qeverisjes **demokratike përmes** parimeve të pjesëmarrjes qytetare, llogaridhënies dhe transparencës gjatë gjithë Programit. Në të gjitha projektet e mbështetura, parimi i **barazisë gjinore** do të integrohet sistematikisht. Ai përfshin masa që do të përqendrohen në forcimin e rolit të grave në qeverisjen demokratike, në politikë dhe ekonomi.

Buxheti për periudhën 2021-2024

Buxheti i Programit Zviceran për Bashkëpunim është 65 milion franga zvicerane që i dedikohen prioriteteve tematike në vijim:




Progresi i konsiderueshëm i arritur deri më tani

Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në vendimmarrje si dhe krijimi i politikave të bazuara në nevoja reale falë kapaciteteve të rritura të qytetarëve dhe institucioneve komunale.

Forcimi i pavarësisë, llogaridhënies dhe efektivitetit të Parlamentit si rezultat i krijimit dhe rritjes së kapacitetit të Institutit Parlamentar.

Kompanitë lokale krijuan lidhje me tregje të reja dhe arritën shitje shtesë prej 1 miliard denarë falë mbështetjes për zhvillimin e ekosistemit afarist.



Organizatrat e shoqërisë civile të forcuara dhe të aftësuara për të luftuar për ndryshimet shoqërore në një mënyrë më të koordinuar.

Sipërfaqja e zonave të mbrojtura në Maqedoninë e Veriut është rritur për 20%, pra aktualisht, ato përbëjnë 11% të territorit të përgjithshëm.

Mijëra të rinj janë punësuar falë aftësive të reja përkatëse që i fituan.

230,000 njerëz fituan shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura dhe 120,000 njerëz fituan shërbime të përmirësuara të furnizimit me ujë, falë investimit zviceran.

PYETJE?

skopje@eda.admin.ch

www.eda.admin.ch/north-macedonia